Pjesë e
Grupit ProCredit

ProCredit Bank

Banka ProCredit sh.a, Rr. "Dritan Hoxha", Tirane, Shqiperi

**No. Prot:** PR - 0080

**Data:** **21.12.2023**

# FTESE PER OFERTE

I nderuar Partner,

E themeluar ne vitin 1995, ne jemi pjese e grupit nderkombetar ProCredit. Ne jemi te mbikqyrur nga autoritete te larta te supervizimit gjerman, Bundesbank dhe BaFin qe sigurojne besueshmerine dhe qendrueshmerine tone.

Qendrueshmeria dhe besueshmeria jone, garantohet gjithashtu nga aksioneret tane. Ne jemi nje banke me nje kapital 100 % gjerman dhe aksioneri yne i vetem eshte ProCredit Holding, me qender ne Frankfurt, Gjermani, i cili ofron drejtim strategjik per grupin e bankave ProCredit.

## *I.* ***Hyrje***

Banka ProCredit eshte e interesuar per sherbime (projektuese dhe studimore) me natyre arkitektonike, inxhnierike dhe mbikqyrjes se punimeve per nevoja te saj.

Per realizmin e ketij sherbimi Banka eshte e interesuar te kontraktoje subjekte qe do te permbushin te gjitha kerkesat dhe kualifikimet e duhura per kryerjen e sherbimeve te nevojshme te cilat perfshihen ne menyre te detajuar ne Aneksin 1 bashkangjitur kesaj ftese.

Banka ushtron aktivitetin e saj prane Zyrave Qendore dhe ne rrjetin e Njesive te Biznesit ne Tirane dhe rrethe.

## II. ***Objekti i Fteses per Oferte***

**Realizimi i sherbimeve (projektuese dhe studimore) me natyre arkitektonike, inxhnierike dhe mbikqyrjes se punimeve per nevoja te ProCredit Bank.**

Kjo Ftese per Oferte perbehet nga:

| | | |
|---|---|---|
| **1.** | **Ftesa per Oferte** | **3 faqe** |
| **2.** | **Aneksi Nr. 1** | **1 faqe** |
| **3.** | **Kushtet paraprake te kontrates** | **1 faqe** |
| **4.** | **Letra Anti Korrupsion** | **2 faqe** |
| **5.** | **Deklarata e gjendjes gjyqesore** | **1 faqe** |
| **6.** | **Formulari ILO** | **2 faqe** |
| **7.** | **Aneksi Nr. 2** | **2 faqe** |
| **8.** | **Formulari i Ofertes** | **1 faqe** |

## *III. Oferta*

Oferta juaj duhet te perbehet nga:

**A. Oferta Ligjore**, e cila paraqet *Kriteret e Pranimit/Kualifikimit dhe* duhet te perpilohet sipas kerkesave te renditura me poshte.

1. Ekstraktit historik per te dhenat e shoqerise leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit.
2. Nje dokument qe verteton se subjekti juaj i ka shlyer detyrimet tatimore, leshuar nga Administrata Tatimore.
3. Nje dokument qe vërteton se subjekti juaj i ka paguar kontributet e sigurimeve shoqerore, lëshuar nga Administrata Tatimore.
4. Deklarate per gjendjen gjyqesore te shoqerise sipas formatit bashkengjitur kesaj ftese per oferte.
5. Subjekti juaj, duhet te provoje se eshte i liçensuar per kryerjen e sherbimeve te projektimit, studimit dhe mbikqyrjes se punimeve sipas kategorive te meposhtme:

   - per projektim studim ne kategoritë 2a, 2c, 3a, 4a,4c,4j,8a,8b,8c9a,12b,
   - per mbikqyrje kolaudim ne kategoritë NP 2, NS 2, NS 4, NS 12, NS 14

***Shenim:***

*Dokumentacioni i kerkuar ne Kriteret e Pranimit/Kualifikimi **ne pikat nga 1, 2 dhe 3**, duhet te vertetohet permes dokumentave te leshuar **jo me pare se tre muaj** nga data e fundit e dorezimit te ofertes. Dokumentat e mesiperme mund te paraqiten origjinal/ te noterizuar ose kopje te dokumentave origjinale.*
*O fertuesit te shpallur fitues do ti kerkohet ky dokumentacion ne origjinal ose fotokopje te noterizuar.*
*N e rast se per realizimin e objektit te kontrates subjektet do te paraqiten si bashkim operatoresh, përveç marrëveshjes se lidhur midis tyre bashkimi i operatoreve duhet te paraqes dokumentat e kërkuar me lart tek kriteret e kualifikimit.*

**B. Oferta teknike (Kriteret e vleresimit te cilesise)**

**1.** Kapaciteti teknik dhe eksperienca te ngjashme:

Subjekti juaj, duhet te provoje se disponon aftesite teknike per realizimin e objektit te kerkuar, ne kete proces tenderimi permes dokumentacionit si me poshte:

- CV e detajuar e subjektit per aktivitetin e tij qe nga data e themelimit ku te perfshihen te gjitha eksperiencat tuaja te meparshme. Pjese e CV-se duhet te jete dhe perberja e stafit ose paleve te treta te kontraktuara ku te detajohen kualifikimet e tyre profesionale apo cdo sqarim shtese qe konfirmon kualifikimin e tyre per kryerjen e sherbimeve te kerkuara.
- Leter reference/kopje kontratash per te cilet subjekti juaj ka kryer realizime te ngjashme se bashku me kopjet e kontratave perkatese.

**2. Kerkesa te tjera teknike:**
Lutemi te na dergoni kopje te certifikatave ISO nese dispononi( e preferueshme ISO 14001).

**C. Oferta Ekonomike**

Subjekti duhet te respektoje formatin e kesaj Ftese per Oferte ne kuotimin e kerkuar.
Ju duhet te paraqitni oferten tuaj sipas Aneksit Nr.1 me çmimet perkatese (te gjitha kostot e paparashikuara ne kete ftese per oferte duhet te perfshihen ne cmim). Te gjitha detyrimet tatimore duhet te jene te perfshira ne cmim.

## *IV. Dorezimi i Ofertes*

Oferta juaj duhet te jete e ndare:

- **dokumentacioni ligjor dhe teknik do te dorezohet ne forme elektronike ne adresen:** info_procurement@procredit-group.com
  Letra Antikorrupsion, Deklarata mbi Gjendjen Gjyqesore (pjese e fteses per oferte) si edhe Formulari ILO, duhet te firmosen, vulosen nga shoqerite dhe te dergohen se bashku me oferten tekniko – ligjore.

- **oferta ekonomike do te dorezohet ne nje zarf qe duhet te jete** i vulosur nga shoqeria ne pjesen e ngjitjes se tij. Ai duhet te kete te shkruar qarte: **Realizimi sherbimeve (projektuese dhe studimore) me natyre arkitektonike, inxhnierike dhe mbikqyrjes se punimeve per nevoja te ProCredit Bank** , si dhe Emrin e Subjektit qe e dergon. Zarfi duhet te protokollohet prane recepsionit te Zyrave Qendrore te PCB-se dhe Shoqeria duhet te sigurohet qe kjo oferte eshte protokolluar. Per te shmangur cdo paqartesi, kerkojme qe perfaqesuesi i shoqerise te mos largohet nga Zyrat Qendrore te PCB-se pa marre numrin e protokollit te ofertes. **Ne total duhet te jete nje numer protokolli**.
  Formulari i Ofertes (pjese e fteses per oferte), duhet te firmoset, vuloset nga subjekti dhe te dergohet se bashku me oferten ekonomike.

Ne rast se oferta juaj ekonomike dorezohet e hapur, me e-mail, fax ose ne ndonje menyre tjeter nga ajo e kerkuar me lart, oferta nuk do te konsiderohet e vlefshme.

Oferta juaj ekonomike, ne nje zarf te mbyllur dhe te vulosur, ne formatin e kerkuar do te adresohet dhe paraqitet ne:

**Ref : RFO-14-11-2023: "Realizimi sherbimeve (projektuese dhe studimore) me natyre arkitektonike, inxhnierike dhe mbikqyrjes se punimeve per nevoja te ProCredit Bank.".**

**ProCredit Bank sh.a.**
**Rr. Dritan Hoxha, Laprake, Tirane.**
**Tirane**

## V. *Vleresimi i ofertes*

- Pas shqyrtimit te ofertes tekniko – ligjore, Banka do te procedoje me hapjen e ofertes financiare.
- Banka do te perzgjedhe fitues subjektin qe ka ofruar oferten me te pershtatshme per te.
- Afati i parashikuar per marreveshjen e bashkepunimit eshte dy vjet.

## VI. *Afati i dorezimit*

- Afati i fundit per dorezimin e ofertes sipas kerkesave te siperpermendura eshte **data 28 Dhjetor 2022, ora 16:00.**

Per cdo pyetje ju lutem mos hezitoni t'i adresoni ne: info_procurement@procredit-group.com.

Banka do te njoftoje me shkrim nese ju jeni fitues ose jo per procesin e tenderimit.

Per cdo ankese ne lidhje me vendimin per procesin e prokurimit ju lutemi mos hezitoni t'i adresoni ne: albankesaprokurime@procredit-group.com

Ju lutem percaktoni ne oferten tuaj menyren e marrjes se kesaj Ftese per Oferte duke vendosur nje kryq per nje nga menyrat e meposhtme:

a) derguar me poste nga banka ________
b) nepermjet internetit ________
c) eshte terhequr prane bankes ________
d) nga shoqeri te tjera ________

*Sinqerisht,*
**ProCredit Bank sh.a**

ProCredit Bank sh.a. Drejtoria e Përgjithshme Tiranë

**Aneksi Nr. 1**

**Pershkrimi i punes**

Subjekti i perzgjedhur fitues duhet te marr persiper te ofroje sherbimet si me poshte:

1. Rilevim i sakte trualli ose objekti (i brendshem dhe i jashtem) te kryera sipas nevojes nga nje arkitekt, inxhinier ose topograf i licensuar.
2. Perpilimin e projekteve arkitektonik dhe inxhinierik (konstruktiv, elektrik, konektiviteti, hidraulik, kondicionim/aspirimi) perfshire relacionet perkatese per objektet e bankes, ne funksion te kerkesave specifike, si dhe sigurohet qe keto projekte te ofrojne ambjente funksionale dhe kushte te pershtatshme per ofrimin e sherbimeve dhe performimin e detyrave te stafit.
3. Pregatitjen e planeve dhe raporteve teknike te nevojshme (topografike, sizmike, gjeologjike, etj)
4. Pregatitjen e preventiveve te punimeve per realizimin e projekteve perkates.
5. Perpilimin e planeve te punes ose grafikut te punimeve per nderhyrjet qe behen ne objektet e Bankes, si ne kontekstin e rikonstruksionit, hapjes se nje objekti te ri apo mbylljeve te objekteve ekzistuese.
6. Aplikimin dhe ndjekien e procesit deri ne zbardhje per Kerkese te thjeshte per realizimin e punimeve prane Njesive Bashkiake, Deklarate paraprake punimesh ose Leje Ndertimore, ne Bashkite respektive, (ne perputhje me VKM ne fuqi) per punimet e parashikuara te kryhen ne objektet e Bankes.
7. Vizita perjodike ose vizita sipas kerkeses ne kantier nga grupi i projektimit/projektuesi, per verifikimin e ecurise se punimeve ne perputhje me projektet dhe afatet e percaktuara ne grafikun e punimeve si dhe per zgjidhjen e problematikave te ndryshme qe mund te hasen gjate realizimit te punimeve.
8. Mbikqyrje dhe Kolaudim punimesh sipas ligjeve ne fuqi nga specialiste te licensuar nese eshte e nevojshme.
9. Pergatitjen e relacionit periodik mbi mbarevajtien e punimeve me natyre ndertimore, elektrike, kondicionimit, mobilimit dhe interior/exterior design.
10. Marrjen ne dorezim te objektit dhe konfirmimin e realizimit te punimeve te kryera ne perputhje me projektet e miratuara.
11. Pergatitjen e situacioneve dhe proces-verbaleve sqaruese.

**Kushtet paraprake te kontrates**

**Banka ruan te drejten e ndryshimit te ketyre kushteve paraprake:**

1. Objekti i kontrates eshte ofrimi i sherbimeve projektim dhe supervizim ne varesi te kerkesave te Bankes.
2. Kjo kontrate hyn ne fuqi me nenshkrimin e saj nga palet dhe eshte e vlefshme per nje periudhe ____nga data e nenshkrimit.
3. Pagesa do kryhet pas konfirmimit te sherbimit te kryer ne llogarine bankare te subjektitprane ProCredit bank. Ofertuesi i shpallur fitues do te hap llogari bankare prane Bankes ProCredit (nese nuk ka) brenda 48 oreve nga njoftimi i shpalljes fitues
4. Banka do te aplikoje nje penalitet prej 0,5% te vleres sherbimit per cdo dite vonese nga afati i rene dakort per kryerjen e sherbimit

**Letra Antikorrupsion (Deklarata e Perputhshmerise)**

Grupi ProCredit vlereson se ndikimet etike, shoqerore dhe mjedisore jane pjese e rrjetit te furnizimit. Veç kesaj, ndikimet pozitive mund te arrihen permes blerjes se produkteve dhe/ose sherbimeve me te pergjegjshme, si dhe duke punuar bashkerisht me furnitoret per te ndikuar pozitivisht ne performancen etike, shoqerore dhe mjedisore. Ndaj, Grupi ProCredit pret prej furnitoreve/kontraktoreve te tij qe t'i permbahen nje pakete standardesh minimale per te garantuar pajtueshmerine e angazhimeve te tyre per çeshtjet kryesore shoqerore, mjedisore dhe te administrimit me standardet e larta te ProCredit.

Njesoj siç veprohet me klientet, Grupi ProCredit pret prej furnitoreve dhe kontraktoreve te tij qe te mos angazhohen ne asnje prej veprimtarive te renditura ne Listen e Perjashtimit te ProCredit. Aktivitetet me te rendesishme, por jo te vetmet, qe permban kjo liste jane:

*-Prodhimi ose veprimtarite qe perfshijne forma te demshme ose shfrytezuese te punes se detyruar/punes se demshme per femijet, praktikat diskriminuese ose praktikat qe i pengojne punonjesit te ushtrojne ne menyre te ligjshme te drejtat e tyre te lirise se organizimit dhe te negocimit kolektiv (per hollesi te metejshme, shihni piken a) te Listes se Perjashtimit)*

*-Respektimi i ligjeve dhe rregulloreve kombetare, si dhe konventave dhe marreveshjeve nderkombetare per prodhimin dhe/ose tregtimin e çdo produkti apo veprimtarie (per hollesi te metejshme, shihni piken e) te Listes se Perjashtimit)*

-Shoqeria konfirmon se nuk kryen aktivitete tregtare te gjendura ne listen perjashtimore te ProCredit Grup.

-Duke qene se Grupi ProCredit i permbahet Deklarates Universale per te Drejtat e Njeriut (1948) pret qe te njejten gje te bejne edhe furnitoret dhe kontraktoret e tij. Keshtu, shoqeria tregtare konfirmon se iu permbahet standarteve dhe etikes me te larte te biznesit gjate procesit te tenderit dhe gjate zbatimit te kontrates. Ajo zbaton standartet e Shendetit, Sigurise ne pune, Sigurise Mjedisore dhe standartet e ILO dhe nuk eshte e perfshire ne punen e detyruar ose ne punen e paligjshme te femijeve. Gjithashtu shoqeria konfirmon se nuk eshte e perfshire ne praktika diskriminuese apo praktika qe ndalojne punemarresit e saj per te ushtruar te drejten e tye ligjore per t'u mbledhur dhe anetaresuar ne organizatat e punemarresve.

*-Shoqeria pranon se perfshirja e saj ne nje nga praktikat e paligjshme te permendura me siper, do te sjelle perjashtimin e saj nga procedura e tenderimit ose nderprerjen e kontrates ne menyre te menjehershme nga ana e ProCredit Bank sha.*

- Siç percaktohet ne Kodin e Sjelljes, Grupi ProCredit nuk toleron rastet e pastrimit te parave, mitmarrjes dhe korrupsionit. Prandaj, marredheniet e biznesit nuk mund te krijohen ose te vazhdohen ne rast se mesohet qe nje furnitor potencial eshte i perfshire ne rastet e pastrimit te parave, korrupsionit dhe/ose mashtrimit. Theksohet se Grupi ProCredit nuk pranon ryshfete te asnje forme dhe as nuk pranon angazhimin e furnitoreve ne praktika te tilla.

*Furnitoret dhe kontraktoret qe rezultojne te perfshire ne veprimtari te kesaj natyre, do te perjashtohen nga mundesia per t'u bere partnere.*

-ProCredit Bank do te refuzoje ofertat pjesemarrese ne tender, nese deshmohet ose nese konsiderohet se shoqeria eshte e perfshire ne ndonje rast te pastrimit te parave, mashtrimit ose ne raste korrupsioni gjate procesit te tenderit ose do te anuloje kontraten nese deshmohet se ka ndodhur ndonje nga keto raste gjate procesit te dhenies se kontrates.

-Per qellimet e kesaj politike aktivitetet e meposhtme do te konsiderohen si korrupsion:

*a) Veprimin e te dhenit, pranuarit ose kerkimit te mjeteve te çfaredo vlere, per te ndikuar te ndonje person tjeter juridik, personel te PCB-se ose te ndonje shoqeri tjeter, gjate procesit te tenderimit ose gjate dhenies se kontrates.*

*b) Demtimin e prones se PCB-se, kercenimin e personelit te PCB-se, kercenimin per demtim te reputacionit te PCB-se ose ndonje shoqerie tjeter per te ndikuar ne procesin e tenderimit ose per zbatimin e kontrates se dhene.*

*c) Marreveshjen ne mes te dy ose me shume shoqerive per te imponuar ose per te ndikuar ne tenderet e papershtatshem, tendere me çmime artificiale ose çmime jo konkurruese.*

*d) Falsifikimin e qellimshem, ndryshimin, fshehjen ose paraqitjen e gabuar te informatave te kerkuara ose te paraqitura gjate procesit te tenderit ose gjate zbatimit te kontrates.*

-Per qellimet e kesaj politike veprime te mashtrimit konsiderohen perpjekjet ose pakujdesite e qellimshme per te mashtruar ose perpjekjet per te mashtruar stafin e PCB-se ose shoqerive te tjera, ne menyre indirekte ose te drejtperdrejte, per te perfituar financiarisht ose per t'ju shmangur detyrimeve te percaktuara me kontrate ose me ligj.

*Grupi ProCredit pret prej furnitoreve te tij te angazhohen dhe te respektojne ndershmerisht standardet e percaktuara ne kete dokument. Furnitoret priten te demonstrojne angazhimin e tyre duke bashkepunuar ngushtesisht me Grupin ProCredit, si dhe duke ofruar akses te arsyeshem ne dokumentacionin/informacionin perkates, nese gjykohet e nevojshme. Ne rastin e shkeljeve te renda dhe/ose te vazhdueshme te standardeve te percaktuara ne kete dokument, Grupi ProCredit do te ndermarre hapat e nevojshem per nderprerjen e marredhenieve te biznesit.*

Me nenshkrimin e ketij dokumenti, nenshkruesit konfirmojne autoritetin e tyre per te nenshkruar ne emer te furnitorit dhe per t'u angazhuar per respektimin e standardeve te percaktuara ne te.

**Deklarata per t'u nenshkruar nga furnitori/kontraktori**

Emri i kompanise ______________________________

Numri i regjistrimit ______________________________

Numri i kontrates/tenderit ______________________________

Adresa ______________________________

Data ______________________________

Nenshkrimi i autorizuar ______________________________

Emri ______________________________

Titulli ______________________________

**DEKLARATE MBI GJENDJEN GJYQESORE**

E shoqerise pjesemarrese ne proceduren e prokurimit qe do te zhvillohet ne date _______________ nga Banka ProCredit sh.a. me objekt _______________

Une i nenshkruari __________________me cilesine ___________ te shoqerise ___________________ deklaroj se:

- Shoqeria ____________________ nuk eshte denuar per shkelje penale,
- Shoqeria ____________________ nuk eshte denuar me vendim te gjykates se formes se prere, qe lidhet me aktivitetin profesional,
- Shoqeria _________________nuk eshte ne proces falimentimi

Data e dorezimit te deklarates _____________

Perfaqesuesi i ofertuesit

Nenshkrimi

Vula

## Pyetesori ILO

### Pyetesori i ILO-s per perputhshmerine e furnitoreve

#### 1. Informacione te pergjithshme

| | |
|---|---|
| Emri i kompanise | |
| Produktet kryesore dhe sektori | |
| Shteti/shtetet e prodhimit/operimit | |
| A i eksportoni/ofroni produktet/sherbimet tuaja ne vendet e BE-se? | |

#### 2. Shendeti dhe siguria profesionale

| | |
|---|---|
| A ka vendosur dhe a zbaton kompania juaj procedura per shendetin dhe sigurine profesionale ne perputhje me praktikat e mira nderkombetare te industrise per te parandaluar aksidentet, demtimet dhe semundjet? A mund te rendisni disa nga udhezimet/standardet dhe procedurat perkatese? Sa shpesh rishikohen apo monitorohen ato? | |
| A ka kualifikime/trajnime specifike qe duhet te kete stafi juaj per te kryer detyra te caktuara? Si i ndiqni nevojat per trajnim? Nje here ne sa kohe zhvillohen trajnime? | |
| Si e ndiqni dhe si e raportoni shkallen e demtimeve, semundjeve profesionale, ditet e mungesave, fenomenin e te munguarit ne pune dhe numrin e viktimave qe lidhet me punen? | |
| Si i parandaloni zjarret dhe çfare do te benit ju dhe stafi juaj ne rast emergjence per shkak te nje zjarri? | |
| Nese pyetja vlen per kompanine ne fjale: A e pajisni stafin me pajisje mbrojtese? Nese po, çfare pajisjesh? | |

#### 3. Barazia ne mundesi dhe ne trajtim

| | |
|---|---|
| Si e ndiqni diversitetin ne kompanine tuaj? | |
| Si e parandaloni diskriminimin ne kontekstin e rekrutimit, shperblimit dhe ngritjes ne detyre? A keni mekanizma per shqyrtimin e ankesave? | |
| A aplikoni mekanizma/politika/programe specifike per te inkurajuar grate apo grupet e tjera vulnerabel? Per shembull, ketu mund te perfshihen targetet lidhur me raportin specifik femra-meshkuj, programe mentorimi te projektuara specifikisht, si dhe koncepte specifike per komunikimin me grupet vulnerabel. | |

### a. Dokumentacion shtese

Ju lutemi, ndihuni te lire t'i bashkengjitni pergjigjes suaj per pyetjet e mesiperme dokumentet perkatese (pra, procedura, udhezime, politika dhe standarde, nese deshironi).

### b. Konfirmimi

| ______________________ | ______________________ | ______________________ |
|---|---|---|
| Data dhe vendi | Emri i plote dhe pozicioni | Firma |

*Me nenshkrimin e ketij dokumenti, nenshkruesit konfirmojne se kane autoritetin te nenshkruajne ne emer te kompanise dhe te japin pergjigje plotesisht te verteta.*

**ANEKSI Nr. 2:** *Oferta ekonomike:*

Oferta ekonomike duhet te jete e shprehur ne Leke dhe te perfshije te gjitha detyrimet tatimore. Ajo duhet te jete e detajuar sipas aktiviteteve qe kerkon ky sherbim si ne tabelen e meposhtme.

| Nr. | Lloji i sherbimit | Njesia | Sasia | Cmimi me Tvsh | Shenime | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Rilevim** | | | | | |
| 1 | Rilevim inxhinierik i thjeshte i truallit | $m^2$ | 1 | | | |
| 2 | Rilevim i thjeshte i objekti nga jashte | $m^2$ | 1 | | | |
| 3 | Rilevim i thjeshte i objekti nga brenda | $m^2$ | 2 | | | |
| 4 | Rilevim inxhinierik kadastral, ose GIS i trualli nga topograf i licensuar | $m^2$ | 1 | | | |
| 5 | Rilevim inxhinierik i objekti nga topograf i licensuar | $m^2$ | 1 | | | |
| | **Projekte** | | | | | |
| 6 | Projekt i plote arkitektonik (plane, prerje, pamje 3D, detaje, mobilim, element dizanj, relacionin arkitektonik, etj) | $m^2$ | 1 | | | |
| 7 | Projekt konstruktiv perfshire relacionin teknik | $m^2$ | 1 | | | |
| 8 | Projekt elektrik dhe konektiviteti perfshire relacionin teknik | $m^2$ | 1 | | | |
| 9 | Projekt hidrosanitar perfshire relacionin | $m^2$ | 1 | | | |
| 10 | Projekt kondicionim/aspirimi perfshire relacionin | $m^2$ | 1 | | | |
| | **Preventive, Situacione, Grafike** | | | | | |
| 11 | Preventiv punime arkitektonik | $m^2$ | 1 | | | |
| 12 | Preventiv punime konstruktive | $m^2$ | 1 | | | |
| 13 | Preventiv punime elektrike dhe konektiviteti | $m^2$ | 1 | | | |
| 14 | Preventiv punime hidrosanitare | $m^2$ | 1 | | | |
| 15 | Preventiv punime kondicionim/aspirimi | $m^2$ | 1 | | | |
| 16 | Grafik punimesh dhe plan pune | cope | 1 | | | |
| 17 | Situacion punime arkitektonik | $m^2$ | 1 | | | |
| 18 | Situacion punime konstruktive | $m^2$ | 1 | | | |
| 19 | Situacion punime elektrike dhe konektiviteti | $m^2$ | 1 | | | |
| 20 | Situacion punime hidrosanitare | $m^2$ | 1 | | | |
| 21 | Situacion punime kondicionim/aspirimi | $m^2$ | 1 | | | |
| | **Aplikime** | | | | | |
| 21 | Aplikim per Kerkese realizim punimesh te thjeshta prane Njesive Bashkiake | sherbim | 1 | | | |
| 22 | Aplikim online per deklarate paraprake punimesh ndertimore | sherbim | 1 | | | |
| 23 | Aplikim online per Leje Punimesh ndertimore | sherbim | 1 | | | |
| | **Projekte te pjeseshme** | | | | | |
| 24 | Plan shfrytezimi per organizim ambjentesh | $m^2$ | 1 | | | |
| 25 | Renderizim perfshire pregatitjen e skemes 3D | $m^2$ | 1 | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 26 | Designe mobiljesh specifike perfshire skedat teknike per prodhimin e tyre | m²/cope | 1 | | | |
| 27 | Designe dhe ideim pozicionimi logosh dhe reklamash shoqeruar me skeden perkatese teknike | m² | 1 | | | |
| | **Raporte** | | | | | |
| 28 | Raport Gjeologjik | objekt | 1 | | | |
| 29 | Raport Sizmik | objekt | 1 | | | |
| | **Supervizim / mbikqyrje** | | | | | |
| 30 | Vizite ne kantier per kontroll dhe verifikim punimesh ne Tirane perfshire raportin periodik dhe final ne forme Proces Verbali | vizite | 1 | | | |
| 31 | Vizite ne kantier per kontroll dhe verifikim punimesh ne rrethe perfshire raportin periodik dhe final ne forme Proces Verbali | vizite | 1 | | | |
| 32 | Mikqyrje, kolaudim specialist i licensuar punimesh ne Tirane | m² | 1 | | | |
| 33 | Mikqyrje, kolaudim specialist i licensuar punimesh ne rrethe | m² | 1 | | | |
| 34 | Keshillim/asistence per pune te ndryshme (Tirane-rrethe)* | dp | 1 | | | |
| | **Transport** | | | | | |
| 35 | Transport jashte Tirane | km | 1 | | | |

**Shenim i rendesishem :**

- Monedha e kuotuar duhet te jete ne Leke. Ne cdo rast te ofertimit ne nje monedhe te ndryshme nga Leke, per reference do te merret kursi i kembimit i Bankes se Shqiperise ne daten e fundit te dorezimit te ofertave.
- Vlefshmeria e ofertes duhet te jete gjashte muaj (180 dite) nga data e dorezimit.
- Asnje shpenzim qe shoqerite ofertuese bejne gjate pergatitjes dhe dorezimit te kuotimit te çmimit nuk do te kompensohet.
- Banka ProCredit ka te drejte te anulloje tenderin dhe/ose ndryshoje karakteristikat e tenderit dhe ti ftoje pjesemarresit per te sjelle serish ofertat e tyre.

***ne kete periudhe perjashtohet punimi i zerave te siperpermendur.**

**FORMULAR OFERTE**

*[Ofertuesi duhet te plotesoje kete Formular ne perputhje me udhezimet e treguara. Nuk lejohen ndryshime apo zevendesim te ketij formati.]*

Date: ____/_____/_______
*[plotesoni daten (dite,muaj,vit) e dorezimit te ofertes]*
Numri i fteses :RFO-14-11-2023

Per: **ProCredit Bank**
**Departamenti i Mbeshtetjes se Biznesit dhe Kanaleve Digjitale**
**Funksioni Prokurimit**
**Tirane, Shqiperi**

Ne, te nenshkruarit, deklarojme qe:

(a) Ne kemi shqyrtuar dokumentacionin e paraqitur ne kete procedure prokurimi dhe pranojme, pa rezerva ose perjashtime, kerkesat, afatet dhe kushtet e shprehura ne to;

(b) Ne sigurojme furnizimin ne perputhje me Dokumentat e Tenderit, Afatet e Levrimit per Mallrat dhe Sherbimet respektive si me poshte _______________________ *[plotesoni shkurtimisht mallrat, apo sherbimet respektive];*

(c) Ne permbushim gjithe kerkesat ligjore, financiare-ekonomike dhe teknike, te specifikuara ne dokumentat e tenderit si vertetohet nga certifikatat dhe dokumentat e dorezuara me kete deklarate

(d) Cmimi total i Ofertes sone, perfshire cdo detyrim tatimor eshte: _____________________________ *[plotesoni cmimin total te ofertes me numra dhe fjale, si dhe monedhen];*

(e) Oferta jone do te jete e vlefshme nga data e dorezimit te ofertes deri me date.............;

(f) Nese oferta jone do te pranohet, ne angazhohemi te mbajme nje garanci kontrate ne perputhje me dokumentat e tenderit nese kjo eshte e aplikueshme;

(g) Ne nuk kemi konflikt interesi ne perputhje me Letren Antikorrupsion;

(k) Ne kuptojme se kjo oferte, sebashku me njoftimin tuaj zyrtar te shpalljes se fituesit, do te sherbeje si nje kontrate e perkohshme ndermjet nesh, derisa te pergatitet dhe nenshkruhet kontrata zyrtare.

(l) Ne kuptojme qe nuk jeni te detyruar te pranoni oferten me cmimin me te ulet ose çdo oferte tjeter qe ju mund te merrni.

Firmosur:_______________

Date:__________________